

Letërnjoftimi i Komunës së

**PEJËS**

**2014**

Maj, 2015






## Fakte

- Buxheti i Komunës së Pejës ka pasur trend pozitiv të rritjes në katër vitet e fundit. Nga 18 milionë euro sa ka pasur kjo komunë në dispozicion në 2012, gjatë 2014 shuma që kjo komunë ka pasur nën menaxhim ka kapur shifrën e mbi 20 milionë euro.
- Komuna e Pejës gjatë vitit 2014 ka rritur shkallën e të hyrave vetanake në rreth 200 mijë euro në krahasim me një vit paraparok. Kjo rritje ka ardhur kryesisht nga tatimi në pronë dhe nga taksat mbi lejet e ndërtimit.
- Komuna e Pejës ka gjithsejtë 2,225 persona të punësuar, ku përfshihen 266 në Administratë. Peja ka të punësuar një shërbyes civil për 867 banorë. Mesatarja në shkallë vendi është një shërbyes civil për 278 banorë.
- Gjatë vitit 2014 Peja ka angazhuar 18 persona me kontratë mbi vepër.
- Në sektorin e arsimit janë të punësuar 1,511 persona, prej tyre 1,198 janë mësimdhënës. Në Komunën e Pejës raporti nxënës/mësimdhënës është 33.6. Mesatarja në shkallë vendi është 29.9.
- Në sektorin e shëndetësisë janë të punësuar 448 persona. Raporti punonjës shëndetësorë/popullatë në Komunën e Pejës është 218.1. Mesatarja në shkallë vendi është 282.7.
- Gjatë vitit 2014 në Komunën e Pejës janë regjistruar 461 biznese të reja, pjesa më e madhe e tyre i takojnë bizneseve nga fusha e tregtisë. Në Pejë në vitet e fundit ka pasur trend pozitiv të rritjes së bizneseve në fushën e bujqësisë.
- Në të njëjtën periudhë (2014) në Pejë janë shuar 86 biznese, pjesa më e madhe e tyre i takojnë profilit të bizneseve tregtare.
- Kryetari i Pejës Gazmend Muhaxhiri gjatë fushatës zgjedhore ka dhënë 24 premtime në fusha të ndryshme. Deri në maj të 2015, Kryetari i Komunës së Pejës ka përmbushur 25% të premtimeve, ndërsa në shkallë vendi kjo mesatarja është 24%.

## 2 Qeverisja komunale


Komuna e Pejës në zgjedhjet e fundit ka kaluar nga qeverisja e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës tek Lidhja Demokratike e Kosovës. Ish Kryetari i Pejës Ali Berisha ka humbur në balotazh ndaj kandidatit për Kryetar Gazmend Muhaxhiri (LDK). Ky i fundit në raundin e parë ka fituar 41% të votave, kundrejt Berishës që ka marrë 37% të votave. Në balotazh diferenca mes Berishës dhe Muhaxhirit ka qenë 57% në favor të Muhaxhirit, ndërsa 53% ka siguruar ish kryetari Ali Berisha.

Grafikoni nr. 1 Numri i votave në raundin e parë dhe në balotazh ndërmjet Gazmend Muhaxhirit dhe Ali Berishës



Pas zgjedhjeve kreu i Komunës Gazmend Muhaxhiri ka hyrë në koalicion me Partinë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe me Partinë e Drejtësisë (PD).


Grafikoni nr. 2 Ndarja e ulëseve sipas partive në Kuvendin Komunal të Pejës sipas zgjedhjeve të 2013



### 3 Buxheti i Komunës së Pejës


Buxheti i Komunës së Pejës ka pasur trend pozitiv të rritjes në katër vitet e fundit. Nga 18 milionë euro sa ka pasur kjo komunë në dispozicion në 2012, gjatë 2014 buxheti i Komunës së Pejës ka arritur mbi 20 milion euro. Kjo rritje ka ardhur nga rritja e grantit nga niveli qendror në rreth 1 milionë euro për arsim dhe shëndetësi dhe nga rritja e të hyrave komunale.

Grafikoni nr.3 Buxheti total i Komunës së Pejës dhe ndarjes sipas kategorive




Komuna e Pejës gjatë vitit 2014 ka rritur shkallën e të hyrave vetanake për 200 mijë euro në krahasim me vitin paraprak. Kjo rritje ka ardhur kryesisht nga tatimi në pronë dhe nga taksat mbi lejet e ndërtimit.

Grafikoni nr.4 Të hyrat vetanake të Pejës nga vitit 2011-2014




Komuna e Pejës pjesën më të madhe të hyrave komunale e siguron nga tatimi në pronë. Nga 3.2 milion euro të hyra vetanake të Komunës së Pejës më 2014, mbi 1.4 milion janë arkëtuar nga tatimi në pronë.

Grafikoni nr.5 Kategoritë e të hyrave buxhetore në Pejës për vitin 2014




Peja bënë pjesë në mesin e komunave të medha për sa i takon të hyrave komunale. Kjo komunë qendron pas Prishtinës, Prizrenit, Ferizajt dhe Gjilanit të cilat kanë të hyra me shumë se Peja gjatë një viti.

Grafikoni nr.6 Krahasimi i komunave nga vështrimi i të hyrave vetanake për vitin 2014




Grafikoni nr.7 Shpenzimi të buxhetit në Pejë sipas shumës dhe kategorie



## 4 Të punësuarit në sektorin publik

Komuna e Pejë ka gjithsejtë 2,225 persona të punësuar, ku përfshihen 266 në administratë dhe të tjerët janë në sistemin shëndetësor, atë arsimor gjegjësisht atë parashkollor, para fillor, fillor dhe të mesëm.


Grafikoni nr.8 Të punësuarit në sektorin publik në Komunën e Pejë



INSTITUTI GAP


Peja ka të punësuar një shërbyes civil për 867 banorë. Mesatarja në shkallë vendi është një shërbyes civil për 278 banorë.

Grafikoni nr.9 Raporti i të punësuarve në administratë për kokë banori



Përveç të punësuarve me kontrata të rregullta, gjatë vitit 2014 Peja ka angazhuar edhe 18 persona me kontratë mbi vepër, apo kontrata të përkohshme të punës.

Grafikoni nr.10 Të punësuarit me kontratë mbi vepër sipas disa komunave




Në sektorin e arsimit janë të punësuar 1,511 persona, prej tyre 1,198 janë mësimdhënës. Në Komunën e Pejës raporti nxënës/mësimdhënës është 33.6. Mesatarja në shkallë vendi është 29.9.



Grafikoni nr.11 Raporti nxënës/mësimdhënës në Komunën e Pejës


### Raporti Nxënës/Mësimdhënës



Në sektorin e shëndetësisë janë të punësuar 448 persona. Raporti punonjës shëndetësorë/popullatë në Komunën e Pejës është 218.1. Mesatarja në shkallë vendi është 282.7.

Grafikoni nr.12 Të punësuarit në shëndetësi sipas numrit dhe llogaritjes për kokë banori nëpër komuna


### Punonjës shëndetësor për kokë banori



## 5 Ekonomia lokale


Gjatë vitit 2014 në Komunën e Pejës janë regjistruar 461 biznese të reja, pjesa më e madhe e tyre i takojnë bizneseve nga fusha e tregtisë. Në Pejë në vitet e fundit ka pasur trend pozitiv të rritjes së bizneseve në fushën e bujqësisë.

Grafikoni nr.13 Trendi i hapjes së bizneseve në Komunën e Pejës 2011-2014 sipas llojit



Në të njëjtën periudhë, në Pejë janë shuar 86 biznese, pjesa më e madhe e tyre i takojnë profilit të bizneseve tregtare.

Grafikoni nr.14 Shuarja e bizneseve në Pejës në total dhe sipas llojit 2011-2014



## 6 Premtimet

Instituti GAP ka monitoruar premtimet e dhëna nga z. Gazmend Muhaxhiri gjatë fushatës zgjedhore 2013. Nga 24 premtimet e monitoruara, deri në maj 2015 z. Muhaxhiri ka arritur të realizoj 25% të premtimeve. Mesatarja e premtimeve të realizuara për të gjitha komunat e Kosovës deri në maj 2015 është 24%.

Grafikoni nr.15 Numri i premtimeve dhe shkalla e realizimit





**Instituti GAP**

Rr.Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Kati 2  
+381 38 609 339

[info@institutigap.org](mailto:info@institutigap.org)  
[www.institutigap.org](http://www.institutigap.org)  
[www.komunat.institutigap.org](http://www.komunat.institutigap.org)